



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 152 / Prot
5

Vlorë më 11.04.2025

VENDIM

Nr. 32, datë 11.04.2025

**PËR
EMËRIMIN E ADMINISTRATORIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI",
VLORE**

Në zbatim të neneve 49 pika 1, gërma "g" dhe nenit 51 pika 2 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neneve 25 pika 1, gërma "g" dhe 40 pika 2, të Statutit të UV-së, në mbledhjen e datës 11.04.2025, Bordi i Administrimit mori në shqyrtim dokumentacionin e kandidatëve sipas listës së përcjellë nga Senati Akademik me vendim nr. 42, datë 09.04.2025 "Për miratimin e listës së kandidatëve që plotësojnë kriteret për Administrator në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë".

Për sa më sipër në përfundim të procedurës së përzgjedhjes së kandidatit për pozicionin e punës "Administrator" në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të emërojë Administrator të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Z. Grigor Dede.
2. Bashkëlidhur këtij vendimi tabela e pikëzimit për kandidatin.
3. Një kopje e këtij vendimi i bëhet më dije Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Degës së Thesarit Vlorë si dhe të gjitha strukturave në UV.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

SOTIR NIKOLLA

Adresa /Adress: Bulevardi Vlorë - Skelë
Tel. Fax ++355222288

Web-sjtë: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al





TABELA E PIKËZIMIT PËR VLËRËSIMIN E KRITEREVE PËR ADMINISTRATOR NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE

Nr	Emër/mbiemër	Eksperienca në punë	Gjuhë e huaj	Njohuritë në fushën kompjuterike	Trajnime dhe kualifikime të lidhura me fushën	Vlerësime pozitive të përvojave të mëparshme të punës (për çdo referencë 5 pikë)	Intervista	Totali
1	Grigor Dede	10 pikë	10 pikë	10 pikë	5 pikë	10 pikë	38 pikë	83 pikë
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								



KRYETAR

SOTIR NIKOLLA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 104 / 14 Prot.

Vlorë më, 08.04 2025

VENDIM

Nr. 42, datë 08.04.2025

PËR

**MIRATIMIN E LISTËS SË KANDIDATUARVE QË PLOTËSOJNË KRITERET
PËR ADMINISTRATOR NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE**

Në mbështetje të nenit 51, pika 2, gërma c të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 40, pika 2 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Senati Akademik në mbledhjen e datës 08.04.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e kandidaturave që plotësojnë kriteret për Administrator në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë si më poshtë vijon:
 - Grigor Dede
2. Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e listës së kandidaturave i përcillet Bordit të Administrimit.
3. Bashkëlidhur vendimit, dokumentacioni i Komisionit *ad-hoc*:
 - Proçesverbal për inventarizimin e dokumentacionit të dosjeve personale të kandidatëve për pozicionin e punës "Administrator" në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.
 - Relacioni për vlerësimin e dokumentacionit të kandidatëve për pozicionin e punës "Administrator" në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
KOMISIONI AD-HOC

Nr. 938 / Prot.

Vlorë më, 01.04.2025

Lënda: Relacion mbi dokumentacionin e dosjeve personale të kandidatëve, për pozicionin e punës "Administrator" në Universitetin "Ismail Qemali"

SENATIT AKADEMIK TË UV-së

Referuar Vendimit nr. 33, datë 19.03.2025 të Senatit Akademik "Për miratimin e komisionit ad-hoc për vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët për Administrator në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, Vendimit Nr. 13, datë 28.02.2025 të Bordit të Administrimit "Për kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes së Administratorit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, Ligjit Nr.80/ 2015 «Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë» Neni 51, Statutit të Universitetit të Vlorës, neni 40 pika 2, referuar shkresës me Nr. 938/3 Prot, datë 25/03/2025 "Procesverbal mbi dorëzimin e zarfave për vendin e lirë të punës për Administrator" të Specialistes së personelit Anisa Bozhani -Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës.

Komisioni Ad-hoc i përbërë nga:

*Prof. Asoc. Denada Sota
Prof. Asoc. Stela Frakulla
PHD. Juljana Xhindoli*

pasi mori në dorëzim dosjet e kandidatëve:

1. *Siri Hoxha*
2. *Grigor Dede*

shqyrton dokumentacionin e dosjeve përkatëse për pozicionin e punës Administrator në UV në përputhje me Vendimin Nr. 13, datë 28.02.2025 të Bordit të Administrimit "Për kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes së Administratorit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

KOMISIONI AD-HOC

I. Kandidati Siri Hoxha:

1. Formulari i aplikimit. *(është në dosje)*
2. Fotokopje e kartës së identitetit. *(është në dosje)*
3. Një kopje e jetëshkrimit- CV. *(është në dosje)*
4. Kopje e noterizuar e diplomës /diplomave dhe ose njehsimin e tyre në MASR bashkë me listën e notave të noterizuara (për të dy ciklet e studimit):
 - a. Diplomë (Nr. i Matrikullimit PVESSA040136, Nr i Diplomes 174) dhe listë notash: Bachelor në Drejtësi, Kolegji Universitar Pavarësia Vlorë, viti 2010-2013, me mesatare aritmetike 9.36, fotokopje e noterizuar. *(është në dosje)*
 - b. Diplomë (Nr. i amzës/ Matrikullimit PV380B020028, Nr i Diplomes 21) dhe listë notash: Master i Shkencave në: "E Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare Publike" Kolegji Universitar Pavarësia, viti 2013 – 2015 me mesatare aritmetike 9.43, fotokopje e noterizuar. *(është në dosje)*
 - c. Diplomë 4 vjecare dhe listë notash, Dega Histori, Fakulteti Histori-Filologji, Universiteti i Tiranës me mesatare aritmetike 9.16, Viti 1991-1995, fotokopje e noterizuar. *(është në dosje)*
 - d. Diplomë Doktrate në Histori, Universiteti i Tiranës fotokopje e noterizuar. Vlerësimi "Shumë Mirë" Viti 2022. *(është në dosje)*
5. Librezë pune - fotokopje e panoterizuar. *(është në dosje)*
 - 5.1 Vërtetim pune i lëshuar nga Rektori I Kolegjit Universitar Pavarësia (12/12/2023):
 - Lektor me kohë të plotë pranë Kolegjit Universitar "Pavarësia" Vlorë, nga viti akademik 2010 - 2011, deri në vitin akademik 2022 - 2023.
 - Gjatë periudhës akademike 2011 - 2012 deri në 2012 - 2013 ka mbuluar detyrën e shefit të departamentit të shkencave politike;
 - Në periudhën 2013 - 2014 ka mbuluar detyrën e Rektorit të institucionit;
 - Në vitet 2014 - 2016 ka mbuluar detyrën e Administratorit të Institucionit;
 - Nga viti akademik 2016 - 2017 deri në 2022 - 2023, ka qenë Zv/Rektor i KUPV. *(është në dosje)*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

KOMISIONI AD-HOC

6. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (*mungon në dosje*)/ Formular vetëdeklarimi 06/03/2025. (*është në dosje*)
7. Vërtetim i aftë për punë 20/09/2024. (*është në dosje*)
8. Vërtetim i lëshuar nga Kolegji Universitar Pavarësia Vlorë që nuk ka masë disiplinore. Lëshuar 12/12/2023. (*është në dosje*)
9. Certifikata të kualifikimeve dhe trajnimeve;
 - Certifikatë e Gjuhës së huaj Angleze Niveli C2 Bulats University of Cambridge 2015. Fotokopje e noterizuar. (*është në dosje*)
 - Certifikatë "International Language Centre" - gjuhë e huaj Anglisht 2001. (*është në dosje*)
 - Diplomë e ciklit të studimeve Europiane dhe Ndërkombëtare (DEEI – Master) e panjehsuar nga ministria, "Diplôme De 3e Cycle D'etudes Européennes & Internationales (Deei-Master)", (*është në dosje*)
 - Certifikatë pjesëmarrje në sesionin shkencor me temë "Menaxhimi në ditët e sotme". Fotokopje e noterizuar. (*është në dosje*)
 - Certifikatë pjesëmarrje në ëorkshopin organizuar në kuadër të projektit TEAVET Durrës. 2019 (*është në dosje*)
 - Certifikatë pjesëmarrje në konferencë 2012. (*është në dosje*)
 - Certifikatë pjesëmarrje me prezantim në konferencën e organizuar nga CDE 2012.
 - Certifikatë pjesëmarrje me prezantim në konferencën e organizuar nga ICTEA-2012. (*është në dosje*)
 - Certifikatë pjesëmarrje me prezantim në konferencën e organizuar nga ICTEA-2013. (*është në dosje*)
 - Certifikatë pjesëmarrje në konferencë 2012. (*është në dosje*)
 - Certifikatë pjesëmarrje në ëorkshopin organizuar nga Kolegji Universita Pavarësia Vlorë. (*është në dosje*)
 - Certifikatë pjesëmarrje me prezantim në konferencën e organizuar nga ICTEA-2015 2 referime. (*është në dosje*)
 - Certifikatë pjesëmarrje me prezantim në konferencën e organizuar nga ICTEA-7-2018. (*është në dosje*)
 - Certifikatë Anëtar Bordi Shkencor – Konferenca- ICEBTT 17. (*është në dosje*)
 - Certifikatë trajnimi 2012 Auleda/ AKCE/ Kolegji Universita Pavarësia. (*është në dosje*)
 - Certifikatë trajnimi 1 mujor intensive pasuniversitar "Lidership dhe menaxhim krizash" 2007. (*është në dosje*)
 - Certifikatë kompjuteri (Subjekti privat "Esmeralda Celaj Vlorë". (*është në dosje*)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

KOMISIONI AD-HOC

10. Letër referencë:

1. Lëshuar nga Prof. Dr. Luan Gjoncaj ish Rektor, Kolegjit Universitar Pavarësia Vlorë. 20/09/2023. (është në dosje)
2. Lëshuar nga Prof. Dr. Hivzi Muharremi, Rektor, Kolegjit Universitar Pavarësia Vlorë. 20/09/2023. (është në dosje)

Shënim:

Në bazë të shkresës me nr.938/5 prot, date 26.03.2025 "Kërkesë për informacion shtesë në lidhje me vlefshmërinë e diplomave të Z.Siri Hoxha drejtuar MAS, po ju vendosim në dispozicion informacionin e ardhur nga Qendra e Shërbimeve Arsimore me nr. 1662/1 prot, datë 02.04.2025 "Kthim përgjigje për verifikim" në të cilën citohet se:

".....QSHA ka nisur të pajisë me numër matrikullimi studentët e regjistruar në IAL-të publike dhe private, duke nisur nga viti akademik 2011-2012 e në vijim. Numri i matrikullimit vendosur në diplomën Bachelor "Drejtesi" nuk është lëshuar nga QSHA, por nga vete IAL-ja. Si rrjedhojë, QSHA nuk mund të verifikojë numrin e matrikullimit të vendosur në këtë diplomë.

Gjithashtu, me numrin e matrikullimit të vendosur në diplomën Master i Shkenaceve "E Drejte Publike dhe Ndërkombëtare Publike" nuk figuron asnjë student në sistemin e QSHA-së".

Përsa më sipër kandidati z. Siri Hoxha nuk plotëson kriterin 1/a, pika 1 (Kriteret e vecanta) të Vendimit Nr. 13, datë 28.02.2025 të Bordit të Administrimit.

II. Kandidati Grigor Dede

1. Formulari i aplikimit. (është në dosje)
2. Fotokopje e ID. (është në dosje)
3. Një kopje e jetëshkrimit- CV. (është në dosje)
4. Kopje e noterizuar e diplomës /diplomave dhe ose njehsimin e tyre në MASR bashkë me listën e notave të noterizuara (për të dy ciklet e studimit):
 - Diplomë dhe listë notash: DIND, Dega Administrim Biznesi Universiteti "Ismail Qemali Vlorë 2006-2010 me mesatare aritmetike 8.52, fotokopje e noterizuar. (është në dosje)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

KOMISIONI AD-HOC

- Vërtetim: Master i Shkencave në "Pasuritë e Paluajtshme" Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë 2017-2019 dhe listë notash me mesatare aritmetike 9.85. Origjinale. *(është në dosje)*
 - Diplomë: Master i Shkencave 2-vjeçar në "Kontabilitet dhe Financë, London Metropolitan University", Athinë, Greqi 2013, dhe e njehësuar nga MAS si Master i Shkencave (dt 29/10/2013), fotokopje e noterizuar. *(është në dosje)*
5. Librezë pune: Pedagog me kohë të plotë, datë 10 Tetor 2011 e në vazhdim Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Fotokopje e panoterizuar. *(është në dosje)*
- 5.1 Vërtetim punësimi Pedagog me kohë të plotë, dt. 10 Tetor 2011 e në vazhdim Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë dhe që nuk ka masë disiplinore i lëshuar nga Rektori i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë 2025. Origjinale.
6. Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore (05/03/2025) / Vërtetim nga Prokuroria (03.03.2025). / Formular vetëdeklarimi. *(janë në dosje)*
7. Vërtetim i gjendjes shëndetësore: Raport Mjeko-Ligjor (03/03/2025) dhe Librezë Shendetësore (Mars 2025). *(janë në dosje)*
8. Vërtetim nga punëdhënës të mëparshëm që nuk kanë masë disiplinore në fuqi:
- a. Vërtetim punësimi Pedagog me kohë të plotë, dt. 10 Tetor 2011 e në vazhdim Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë dhe që nuk ka masë disiplinore i lëshuar nga Rektori i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë 2025. Origjinale.
9. Certifikata të kualifikimeve dhe trajnimeve *(gjenden në dosje)*:
- Certifikatë e Gjuhës së huaj:
 - Anglisht Bulats University of Cambridge Niveli C2, Viti 2015. Fotokopje dhe origjinali.
 - Anglisht Cambridge B2, Viti 2014. Fotokopje dhe origjinali.
 - Certifikatë pjesëmarrje Erasmus:
 - Teacher Mobility- Bullgari, 1 javor, Prill 2023. Fotokopje dhe origjinali.
 - Teacher Mobility- Sllovaki, 1 javor, Qershor 2023. Fotokopje dhe origjinali.
 - Training Mobility- Kroaci, 1 javor, Prill 2024. Fotokopje dhe origjinali.
 - Certifikatë pjesëmarrje në trajnim për Këshilltarët Bashkiak. Fotokopje dhe origjinali.
 - Dëshmi: Financa 5, Viti 2010. Fotokopje dhe origjinali.
10. Dëshmi të njohurive të programeve bazë kompjuterike;
- a. Certifikatë kompjuteri: Viti 2025. Fotokopje dhe origjinali.
11. Referenca nga punëdhënës të mëparshëm, që provojnë vlerësimet pozitive në punë:
- a. Lëshuar nga Prof. Dr. Albert Qarri pedagog pranë UV Vlorë. 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

KOMISIONI AD-HOC

b. Lëshuar nga Rozeta Rrapi, Kryetar i degës Kryqi i kuq Shqiptar 2023, Vlorë

Përsa më sipër kandidati z. Grigor Dede i plotëson kriteret e Vendimit Nr. 13, datë 28.02.2025 të Bordit të Administrimit.

Bashkëlidhur shkresa e Qendrës së Shërbimeve Arsimore me nr. 1662/1 prot, datë 02.04.2025 "Kthim pergjigje për verifikim"

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin tuaj!

Komisioni Ad-hoc:

Prof. Asoc. Denada Sota

Prof. Asoc. Stela Frakulla

PHD. Juljana Xhindoli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTOR

Nr. 938/5 Prot
10

Vlorë, më 02.04.2025

Lënda: Përcjellje informacioni

KRYETAR I KOMISIONIT AD-HOC
PROF. ASOC. DENADA SOTA

KËTU

Në përgjigje të shkresës suaj me nr.938/5 prot, datë 26.03.2025 "Kërkesë për informacion shtesë në lidhje me vlefshmërinë e diplomave të Z.Siri Hoxha po Ju përcjell shkresën e Qendrës së Shërbimeve Arsimore me nr. 1662/1 prot, datë 02.04.2025 "kthim përgjigje për verifikim"

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin tuaj,

REKTOR

Prof. Dr. Aurela SALIAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. 1662/prot.

Tiranë, më 04.04.2025

Lënda: Kthim përgjigje: "Kërkesë për verifikim".

UNIVERSITETIT ISMAIL QEMALI

Vlorë

E nderuar Znj. Rektore,

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 938/8 prot., datë 27.03.2025 të administruar pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore me nr. 1662 prot., datë 01.04.2025, lidhur me verifikimin e numrave të matrikullimit, vendosur në diplomat e lëshuara nga ish-Kolegji Universitar "Pavarësia", ju informojmë sa më poshtë:

Në bazë të pikës 9 të Udhëzimit nr. 45, datë 19.12.2011 "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit" i ndryshuar, citohet se: "*Institucionet e arsimit të lartë i dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP), listën e studentëve të regjistruar në vitin akademik 2011-2012 e në vazhdim, në programet e studimit të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë...*"


Sa më sipër, QSHA ka nisur të pajisë me numër matrikullimi studentët e regjistruar në IAL-të publike dhe private, duke nisur nga viti akademik 2011-2012 e në vijim. Numri i matrikullimit vendosur në diplomën Bachelor "Drejtësi" nuk është lëshuar nga QSHA, por nga vetë IAL-ja. Si rrjedhojë, QSHA nuk mund të verifikojë numrin e matrikullimit të vendosur në këtë diplomë.

Gjithashtu, me numrin e matrikullimit të vendosur në diplomën Master i Shkenaceve "E Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare Publike" nuk figuron asnjë student në sistemin e QSHA-së.

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Aida Myrto



per ndjekje
Sek. Bureme Njeverme
Kommuni Ad Doc
[Signature]

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
B. Lico 10.04.25
938/12
07.04.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT TË LARTË DHE
KËRKIMIT SHKENCOR**

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ARSIMIT TË LARTË

Nr. 2096 Prot.

Tiranë, më 07.04. 2025

Lënda: Për shkresën nr. 2096 prot., datë 01.04.2025.

QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE

Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr. 23, Tiranë

Për dijeni: **UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË** ✓

Adresa: Blv. "Vlorë-Skelë", Vlorë

AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë

Bashkëlidhur ju dërgojmë për ndjekje shkresën e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë nr. 938/7 prot., datë 27.03.2025, regjistruar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, me nr. 2096 prot., datë 01.04.2025, me lëndë "Kërkesë për verifikim", në lidhje me diplomat (kopje) që zotëron z. Siri Hoxha, respektivisht "Bachelor" në "Drejtësi" dhe "Master i Shkencave" në "E drejtë publike dhe ndërkombëtare publike", të lëshuara nga Kolegji Universitar "Pavarësia", Vlorë.

Sa më sipër, lutemi, të shqyrtoni këtë kërkesë dhe të informoni Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, duke vënë në dijeni edhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Duke ju falënderuar,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen Tola

